FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare
www.qpz.gov.al

Nr.97 3 korrik 2009

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Vendim i KM nr.540, datë 8.4.2009	Për një shtesë në vendimin nr.260, datë 18.4.2007 të Këshillit të Ministrave "Për botimin, shtypjen dhe shpërndarjen e teksteve shkollore, të sistemit të arsimit parauniversitar", të ndryshuar ……	4251
Vendim i KM nr.547, datë 13.5.2009	Për përcaktimin e procedurave dhe të vlerave të qirasë për sipërfaqet ujore, për ushtrimin e veprimtarisë së akuakulturës intensive ……	4251
Vendim i KM nr.553, datë 2.6.2009	Për shpalljen kategorizimin dhe emërtimin e portit "Vlora-1", në Gjirin e Vlorës, - "Port i hapur për trafik ndërkombëtar"……	4253
Vendim i KM nr.555, datë 13.5.2009	Për miratimin e marrëveshjes, ndërmjet Mbretërisë së Belgjikës dhe Republikës së Shqipërisë, Bosnjës dhe Hercegovinës, Republikës së Kroacisë, ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë, Republikës së Moldavisë, Malit të Zi, Republikës së Serbisë dhe Misionit të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë, në emër të Kosovës, në përputhje me Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, për privilegjet dhe imunitetet e sekretariatit të marrëveshjes së tregtisë së lirë, për Europën Qendrore ……	4255
Vendim i KM nr.556, datë 28.5.2009	Për caktimin e shpërblimit ditor për ushtarakët shqiptarë, të dërguar në Republikën e Çadit dhe Republikën e Afrikës Qendrore, në kuadër të misionit ushtarak "Minurcat", të Organizatës së Kombeve të Bashkuara ……	4263

Vendim i KM nr.558, datë 28.5.2009	Për lejimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Rezervave Materiale të Shtetit të shesë makineritë dhe pajisjet e fabrikës së ushqimeve për fëmijë "Baby food" …….	4264
Vendim i KM nr.560, datë 28.5.2009	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor Kalimash-Morinë ……	4264
Vendim i KM nr.561, datë 28.5.2009	Për një ndryshim në vendimin nr.483, datë 29.7.1996 të Këshillit të Ministrave "Për dhënien me qira të truallit, ku është ndërtuar fshati i fëmijëve, në Tiranë" ……..	4267
Vendim i KM nr.562, datë 28.5.2009	Për hapjen e programit të ri të studimit "Master i nivelit të dytë", pranë shkollës së lartë universitare private "Justiniani I" ……	4267
Vendim i KM nr.563, datë 28.5.2009	Për hapjen e programeve të reja të studimit të ciklit të parë, të dytë dhe "Master i nivelit të parë", pranë shkollës së lartë universitare, private, "Kristal" ……	4268
Vendim i KM nr.564, datë 28.5.2009	Për hapjen e programeve të reja të studimit "Master i nivelit të dytë", pranë shkollës së lartë universitare, private "Universiteti Marin Barleti" ……	4269
Vendim i KM nr.566, datë 28.5.2009	Për pjesëmarrjen e forcave ushtarake të huaja në stërvitjen e përbashkët "Adrion Livex-09", në territorin e Republikës së Shqipërisë ……..	4271
Vendim i KM nr.567, datë 28.5.2009	Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2009, miratuar për Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, për Qendrën Kombëtare të Licencimit ……	4271
Vendim i KM nr.568, datë 28.5.2009	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor "Rruga e Voskopojës, Korçë"..	4272
Vendim i GJK nr.14, datë 3.6.2009	Me objekt shfuqizimin e vendimit nr.00-2007-1470 (1181), datë 18.10.2007 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë ….	4276

VENDIM
Nr.540, datë 8.4.2009

PËR NJË SHTESË NË VENDIMIN NR.260, DATË 18.4.2007 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR BOTIMIN, SHTYPJEN DHE SHPËRNDARJEN E TEKSTEVE SHKOLLORE, TË SISTEMIT TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 9, 56 e 63 të ligjit nr.7952, datë 21.6.1995 "Për sistemin arsimor parauniversitar", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Pas pikës 7 të vendimit nr.260, datë 18.4.2007 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, shtohet pika 7/1, me këtë përmbajtje:

"7/1.Ministria e Arsimit dhe Shkencës mund të miratojë, për përdorim në shkollat shqiptare, edhe tekste të huaja, të përshtatshme për programet e miratuara nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, me kusht që çmimet e këtyre teksteve të jenë të përafërta me çmimet e teksteve të përdorura në Shqipëri. Nëse shtëpitë botuese prodhuese nuk angazhohen në prodhimin e këtyre teksteve enkas për Shqipërinë, Ministria e Arsimit dhe Shkencës merr lejen e botimit prej tyre dhe organizon konkurrimin publik, për të përzgjedhur shtëpinë botuese, që do t'i prodhojë e shpërndajë këto tekste në shkollat shqiptare, sipas pikave të mësipërme të këtij vendimi. Kriteret dhe procedurat e përzgjedhjes së teksteve përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës.".

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.547, datë 13.5.2009

PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURAVE DHE TË VLERAVE TË QIRASË PËR SIPËRFAQET UJORE, PËR USHTRIMIN E VEPRIMTARISË SË AKUAKULTURËS INTENSIVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 5 të nenit 27 të ligjit nr.7908, datë 5.4.1995 "Për peshkimin dhe akuakulturën", të ndryshuar, dhe të nenit 801 të ligjit nr.7850, datë 29.7.1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Sipërfaqet ujore u jepen me qira personave, juridikë e fizikë, vendas apo të huaj, për ushtrimin e veprimtarive të akuakulturës intensive, nëpërmjet procedurës së konkurrimit.

2. Sipërfaqet ujore, që jepen me qira, janë në zonat detare, në ujërat e brendshme (pa përfshirë ujëmbledhësit e bujqësisë, që shërbejnë për ujitje) dhe në liqenet natyrore.

3. Njoftimi për botim për dhënien me qira të zonës shpallet 2 herë në Buletinin e Njoftimeve Publike dhe përmban të dhënat për sipërfaqen, pikët vlerësuese për elementet e konkurrimit, dokumentacionin, që duhet të paraqesin konkurrentët, si dhe vendin, datën e orën e paraqitjes së dokumentacionit. Data e konkurrimit të jetë jo më parë se 7 ditë kalendarike nga data e botimit të fundit.

4. Dokumentacioni, që duhet të paraqesin pjesëmarrësit në konkurrim, është:

- Kërkesa për marrjen me qira të sipërfaqes ujore;

- Regjistrimi në QKR;
- Projekti teknik;
- Planbiznesi i hollësishëm për zhvillimin e veprimtarisë;
- Autodeklarimi se projekti përputhet me kërkesat mjedisore të zonës në fjalë;
- Oferta për tarifën vjetore të detyrimit.

5. Kushtet e pjesëmarrjes në konkurrim janë:

- Garancia financiare, e mjaftueshme për përballimin e investimeve të parashikuara në planbiznes;
- Prania e specialistit të fushës, nëpërmjet CV-së profesionale, ku të tregohet përvoja në fushën e peshkimit dhe të akuakulturës;
- Autodeklarimi se subjekti nuk ka procese gjyqësore në ngarkim, nuk ka detyrime tatimore ose detyrime të tjera.

6. Kriteret e konkurrimit për dhënien me qira të sipërfaqeve ujore janë:

- Niveli i investimit dhe i projektit;
- Niveli i punësimit;
- Tarifa e qirasë vjetore.

7. Me urdhër të ministrit ngrihet dhe vepron komisioni i vlerësimit të kërkesave të paraqitura. Urdhri i ministrit përmban:

a) Të dhënat e zonës: emërtimi, sipërfaqja, qëllimi i përdorimit, çmimi dysheme, afati;

b) Veprimtarinë, që mund të ushtrohet në zonë;

c) Pikët vlerësuese për elementet e konkurrimit, të përcaktuara sipas pikës 6 të këtij vendimi;

ç) Vendin, datën dhe orën, ku paraqiten dokumentet;

d) Përbërjen e komisionit të shqyrtimit të ofertave të konkurrentëve, i cili, në çdo rast, përbëhet nga jo më pak se pesë anëtarë, specialistë të ministrisë;

dh) Dokumentacionin, që duhet të paraqesin konkurrentët.

8. Komisioni i vlerësimit ka këto detyra:

a) Hap, në prani të konkurrentëve, dokumentacionin e paraqitur prej tyre, duke bërë të njohur të dhënat kryesore për çdo ofertë të paraqitur. Kur dokumentacioni i paraqitur nuk është i plotë, konkurrenti skualifikohet në prani të tij;

b) Harton procesverbalin e zhvillimit të konkurrimit, ku përshkruhen pjesëmarrësit, konkurrentët e skualifikuar dhe shkaku, konkurrentët e kualifikuar dhe lista e dokumenteve të paraqitura prej tyre;

c) Bën shqyrtimin brenda 10 ditëve të ofertave të paraqitura dhe vlerëson me pikë çdo element konkurrimi, sipas përcaktimit në urdhrin e ministrit. Subjektit, që paraqet vlerën më të lartë të propozuar, i jepen pikët maksimale për çdo element konkurrimi, ndërsa subjekteve të tjera pikët u llogariten në përpjesëtim të drejtë me vlerën më të lartë, të propozuar;

ç) Rendit, pas përfundimit të konkursit, konkurruesit, në bazë të pikëve të fituara;

d) Paraqet, brenda afatit të përcaktuar në shkronjën "c" të kësaj pike, te ministri një informacion për zhvillimin e konkursit, së bashku me procesverbalin dhe listën e konkurruesve, të renditur sipas pikëve të fituara.

9. Komisioni shpall subjektin fitues. Njoftimi për shpalljen fitues vendoset në këndin e njoftimeve të ministrisë.

10. Subjektet konkurruese, brenda 5 ditëve nga shpallja e subjektit fitues, kanë të drejtën e ankimimit te ministri, i cili, brenda 10 ditëve, i përgjigjet ankuesit me shkrim.

11. Pas përfundimit të procedurave të mësipërme dhe pajisjes me leje mjedisore, ministria ose përfaqësuesi i pronës shtetërore lidh kontratën e qirasë dhe miraton kohëzgjatjen e projektit, i cili nuk mund të jetë më shumë se për 10 vjet.

12. Afati i kontratës për dhënien me qira të sipërfaqes ujore është i njëjtë me kohëzgjatjen e zbatimit të projektit.

13. Për kategoritë ujore të përcaktuara në pikën 2 të këtij vendimi, çmimi i qirasë vjetore është 1 (një) euro për ha. Ky çmim do të zbatohet dhe për kontratat ekzistuese të qirasë, për periudhën që ka mbetur deri në mbarim të kontratës.

14. Pagesa e qirasë është vjetore dhe llogaritet nga data e lidhjes së kontratës. Ajo shlyhet në çastin e lidhjes së kontratës dhe në të njëjtën datë, në vitet pasardhëse.

15. Të ardhurat e siguruara nga dhënia me qira e sipërfaqeve ujore administrohen, në përputhje me shkronjën "b" të pikës 1 të vendimit nr.432, datë 28.6.2006 të Këshillit të Ministrave "Për krijimin dhe administrimin e të ardhurave, që krijojnë institucionet buxhetore".

16. Vendimi nr.135, datë 8.3.2006 i Këshillit të Ministrave "Për procedurat dhe çmimet e dhënies me qira të sipërfaqeve ujore për ushtrimin e veprimtarisë së akuakulturës intensive", me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, shfuqizohet.

17. Ngarkohet Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.553, datë 2.6.2009

PËR SHPALLJEN KATEGORIZIMIN DHE EMËRTIMIN E PORTIT "VLORA-1", NË GJIRIN E VLORËS, - "PORT I HAPUR PËR TRAFIK NDËRKOMBËTAR"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 7 të nenit 18 të ligjit nr.9251, datë 8.7.2004 "Kodi Detar i Republikës së Shqipërisë" dhe të ligjit nr.9231, datë 13.5.2004 "Për ratifikimin e marrëveshjes së koncesionit të formës "BOO", për ndërtimin dhe shfrytëzimin e terminalit bregdetar për depozitimin e naftës dhe të nënprodukteve të saj në gjirin e Vlorës, si dhe për ratifikimin e marrëveshjes së koncesionit të formës "BOT" për ndërtimin dhe shfrytëzimin e infrastrukturës portuale në shërbim të terminalit bregdetar në gjirin e Vlorës", me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpalljen, kategorizimin dhe emërtimin "Port i hapur për trafik ndërkombëtar", të objektit "Port "Vlora -1"", në gjirin e Vlorës, të ndërtuar sipas marrëveshjes së koncesionit të formës "BOT" për ndërtimin dhe shfrytëzimin e infrastrukturës portuale në shërbim të terminalit bregdetar në këtë gji, me specifikat e mëposhtme:

a) Koordinatat gjeografike: N 40^0 27' 53''
E 19^0 26' 17'';

b) Veprimtaria detare: Ngarkim –shkarkim nafte, GNL, e të nënprodukteve të tyre dhe produkteve të tjera;

c) Operativiteti: Port i hapur për trafik ndërkombëtar, 24 orë;

ç) Shfrytëzimi: Faza I: Sipas marrëveshjes koncesionare, gjatë kohëzgjatjes së koncesionit;

Faza II: Pronë e shtetit shqiptar, e lirë, për t'u shfrytëzuar sipas vullnetit të shtetit, pas përfundimit të koncesionit;

d) Menaxhimi: Faza I: Sipas marrëveshjes koncesionare gjatë kohëzgjatjes së koncesionit;

Faza II: Shteti shqiptar, përfaqësuar nga organet qendrore përgjegjëse, në fushën e porteve dhe të zhvillimit ekonomik;

dh) Pronësia: Shteti shqiptar, i përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave.

Kufizime: Në përdorim të koncesionarit "La Petrolifera Italo Albanese sh.a.", gjatë kohëzgjatjes së koncesionit;

e) Marrëdhënia me institucionin përgjegjës për transportin: Raportim periodik për vëllimin e punës së kryer në port;

ë) Detyrime të tjera: Person kontakti dhe adresë kontakti, në çdo kohë;

Faqe zyrtare, në gjuhën shqipe dhe në anglisht, që përmban informacion të plotë për rregullat e funksionimit të portit, tarifat dhe normat ditore të ngarkim-shkarkimit, si dhe informacion për situatën e anijeve në port.

2. Ngarkohen Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Brendshme, Ministria e Financave, Ministria e

Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit të marrin masa, që, në bashkëpunim me koncesionarin, të bëjnë funksionale të gjitha strukturat respektive shtetërore, përfshirë komunikimin nominal të personave, që do t'i ushtrojnë këto funksione në port.

3. Porti do të bëhet funksional (operativ) pas plotësimin të detyrimeve të përcaktuara në pikën 2 të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.555, datë 13.5.2009

PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES, NDËRMJET MBRETËRISË SË BELGJIKËS DHE REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, BOSNJËS DHE HERCEGOVINËS, REPUBLIKËS SË KROACISË, ISH-REPUBLIKËS JUGOSLLAVE TË MAQEDONISË, REPUBLIKËS SË MOLDAVISË, MALIT TË ZI, REPUBLIKËS SË SERBISË DHE MISIONIT TË ADMINISTRATËS SË PËRKOHSHME TË KOMBEVE TË BASHKUARA NË KOSOVË, NË EMËR TË KOSOVËS, NË PËRPUTHJE ME REZOLUTËN 1244 TË KËSHILLIT TË SIGURIMIT TË KOMBEVE TË BASHKUARA, PËR PRIVILEGJET DHE IMUNITETET E SEKRETARIATIT TË MARRËVESHJES SË TREGTISË SË LIRË, PËR EUROPËN QENDRORE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17 e 23 të ligjit nr.8371, datë 9.7.1998 "Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare", me propozimin e Ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes, ndërmjet Mbretërisë së Belgjikës dhe Republikës së Shqipërisë, Bosnjës dhe Hercegovinës, Republikës së Kroacisë, ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë, Republikës së Moldavisë, Malit të Zi, Republikës së Serbisë dhe Misionit të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë, në emër të Kosovës, në përputhje me Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, për privilegjet dhe imunitetet e sekretariatit të marrëveshjes së tregtisë së lirë, për Europën Qendrore, sipas tekstit, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

MARRËVESHJE
NDËRMJET MBRETËRISË SË BELGJIKËS DHE REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, BOSNJË-HERCEGOVINËS, REPUBLIKËS SË KROACISË, ISH-REPUBLIKËS JUGOSLLAVE TË MAQEDONISË, REPUBLIKËS SË MOLDAVISË, MALIT TË ZI, REPUBLIKËS SË SERBISË DHE MISIONIT TË ADMINISTRATËS SË PËRKOHSHME TË KOMBEVE TË BASHKUARA NË KOSOVË NË EMËR TË KOSOVËS, NË PËRPUTHJE ME REZOLUTËN 1244 TË KËSHILLIT TË SIGURIMIT TË KOMBEVE TË BASHKUARA PËR PRIVILEGJET DHE IMUNITETET E SEKRETARIATIT TË MARRËVESHJES SË TREGTISË SË LIRË PËR EUROPËN QENDRORE

Në zbatim të neneve 40, 41 dhe 42 të shtojcës 1 të marrëveshjes mbi amendimin dhe hyrjen në

marrëveshjen e tregtisë së lirë për Europën Qendrore, lidhur më 19 dhjetor 2006, në Bukuresht (në vijim e referuar si CEFTA 2006, ku përcaktohet krijimi i një komisioni të përbashkët me përbërjen e përfaqësuesve të palëve të CEFTA-s;

duke marrë në konsideratë në veçanti nenin 40.2 të shtojcës 1 të CEFTA-s 2006, sipas të cilit komisioni i përbashkët do të mbështetet nga një sekretariat i përhershëm, me qendër në Bruksel dhe do të vendosë për funksionet dhe rregullat administrative të sekretariatit;

duke marrë në konsideratë nenin 5 të vendimit nr.7/2007 të komisioni të përbashkët të marrëveshjes së tregtisë së lirë për Europën Qendrore, miratuar më 28 shtator 2007, për statusin ligjor të sekretariatit dhe, në veçanti, paragrafin 3 të këtij neni, sipas të cilit palët e CEFTA-s do të zhvillojnë bisedime dhe do të arrijnë një marrëveshje për "selinë" apo marrëveshje të ngjashme në vendin pritës;

me dëshirën për të arritur një marrëveshje që përcakton privilegjet dhe imunitetet e nevojshme për funksionimin e sekretariatit të marrëveshjes së tregtisë së lirë për Europën Qendrore dhe për përmbushjen me sukses të misionit të personelit të tij,

kanë rënë dakord si më poshtë:

MARRËVESHJE

NDËRMJET MBRETËRISË SË BELGJIKËS DHE REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, BOSNJË-HERCEGOVINËS, REPUBLIKËS SË KROACISË, ISH-REPUBLIKËS JUGOSLLAVE TË MAQEDONISË, REPUBLIKËS SË MOLDAVISË, MALIT TË ZI, REPUBLIKËS SË SERBISË DHE MISIONIT TË ADMINISTRATËS SË PËRKOHSHME TË KOMBEVE TË BASHKUARA NË KOSOVË NË EMËR TË KOSOVËS, NË PËRPUTHJE ME REZOLUTËN 1244 TË KËSHILLIT TË SIGURIMIT TË KOMBEVE TË BASHKUARA PËR PRIVILEGJET DHE IMUNITETET E SEKRETARIATIT TË MARRËVESHJES SË TREGTISË SË LIRË PËR EUROPËN QENDRORE

Mbretëria e Belgjikës (në vijim e referuar si "Belgjika", nga njëra anë) dhe Republika e Shqipërisë, Bosnjë-Hercegovina, Republika e Kroacisë, ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë, Republika e Moldavisë, Mali i Zi, Republika e Serbisë dhe Misioni i Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë në emër të Kosovës, në përputhje me Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara (në vijim të referuara si "palët e Cefta-s", nga ana tjetër).

KREU I

PERSONALITETI, PRIVILEGJET DHE IMUNITETET E SEKRETARIATIT

Neni 1

Për qëllimin e kësaj Marrëveshjeje:

a) "Vend pritës" është Mbretëria e Belgjikës;

b) "Palët në CEFTA" janë palët e marrëveshjes për amendimin dhe hyrjen në marrëveshjen e tregtisë së lirë për Europën Qendrore, lidhur më 19 dhjetor 2006 në Bukuresht;

c) "Sekretariat" është sekretariati i marrëveshjes së tregtisë së lirë për Europën Qendrore, në mbështetje të nenit 40.2 dhe të nenit 41.5 të shtojcës 1 të marrëveshjes për amendimin dhe hyrjen në marrëveshjen e tregtisë së lirë për Europën Qendrore;

d) "Drejtor" është personi i caktuar si kryetari i sekretariatit të marrëveshjes së tregtisë së lirë për Europën Qendrore;

e) "Personeli" janë anëtarët e Sekretariatit, sipas njoftimit të shërbimit protokollar të shërbimit publik federal të marrëdhënieve me jashtë, në përputhje me nenin 19.3 të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 2

Sekretariati ka personalitet juridik ndërkombëtar dhe zotësi për të vepruar. Sekretariati do të ketë kompetencat e nevojshme ligjore për ushtrimin e funksioneve të veta, përfshirë kompetencën për lidhjen e kontratave, blerjen dhe transferimin e pasurive të luajtshme e të paluajtshme dhe të nisë e të marrë pjesë në procedime ligjore.

Neni 3

Sekretariati, si dhe pronat dhe pasuritë e përdorura për ushtrimin e funksioneve zyrtare të sekretariatit gëzojnë imunitet ligjor, përveç rasteve kur sekretariati heq dorë shprehimisht.

Neni 4

1. Pronat dhe pasuritë e sekretariatit që përdoren për ushtrimin e funksioneve të tij zyrtare nuk mund të jenë objekt i asnjë forme rekuizicioni, konfiskimi, sekuestrimi apo çdo forme tjetër konfiskimi ose kufizimi.

2. Në rastet kur është e nevojshme ndonjë formë shpronësimi, do të ndërmerren të gjitha veprimet e duhura për të parandaluar në çdo mënyrë pengimin e ushtrimit të funksioneve të sekretariatit. Në këtë rast, Belgjika do të ofrojë ndihmën e saj për të mundësuar ricaktimin e sekretariatit.

Neni 5

Arkivat e sekretariatit dhe, në përgjithësi, të gjitha dokumentet e sekretariatit ose ato që mbahen prej tij janë të paprekshme.

Neni 6

1. Mjediset e përdorura ekskluzivisht për ushtrimin e funksioneve zyrtare të sekretariatit janë të paprekshme. Për hyrjen në mjediset e sekretariatit kërkohet leje nga përfaqësuesit e tij.

2. Megjithatë, kjo leje do të konsiderohet e dhënë në rast urgjencash, kur kërkohet veprim i menjëhershëm mbrojtës.

3. Belgjika merr të gjitha masat e duhura për të parandaluar në çdo mënyrë shkeljen apo dëmtimin e mjediseve të sekretariatit, për të parandaluar prishjen e qetësisë së sekretariatit apo cenimin e dinjitetit të tij.

Neni 7

1. Pa cenuar dispozitat ndërkombëtare dhe dispozitat përkatëse të Komunitetit Europian, sekretariati mund të zotërojë monedha belge të çdo lloji dhe të ketë llogari në të gjitha monedhat, deri në shkallën ku është e nevojshme për ekzekutimin e veprimtarive që përkojnë me synimin e tij.

2. Belgjika merr përsipër t'i japë të gjitha autorizimet e mundshme sekretariatit për të transferuar lirisht, në përputhje me mënyrat e përcaktuara nga rregulloret vendase dhe marrëveshjet ndërkombëtare në fuqi, fondet që janë të nevojshme për krijimin dhe funksionimin e sekretariatit.

Neni 8

Sekretariati, pronat e tij, të ardhurat e tij dhe mjetet e tjera të destinuara për përdorimin e tij zyrtar përjashtohen nga të gjitha taksat e drejtpërdrejta.

Neni 9

Kur sekretariati bën blerje të konsiderueshme të pasurive të luajtshme ose të paluajtshme, ose kur përfton shërbime të konsiderueshme, që janë rigorozisht të nevojshme për ushtrimin e veprimtarive të tij zyrtare dhe kur çmimi përfshin taksa të tërthorta apo TVSH, duhet të merren masat e duhura, aty ku është e mundur, që shuma e këtyre taksave të hiqet apo të rimbursohet.

Neni 10

Nuk do të ketë asnjë përjashtim nga taksat e drejtpërdrejta dhe të tërthorta për të ardhurat e sekretariatit që rrjedhin prej një veprimtarie industriale ose tregtare, që është ushtruar nga sekretariati ose nga një prej anëtarëve të tij për sekretariatin.

Neni 11

Sekretariati do të përjashtohet nga të gjitha taksat e tërthorta për mallrat e importuara, të blera apo të eksportuara nga ai vetë apo në emër të tij për përdorim zyrtar nga ana e vet.

Neni 12

Pa cenuar detyrimet e Belgjikës që lindin nga traktatet në lidhje me Bashkimin Europian dhe zbatimin e dispozitave ligjore e rregullatore mbi rendin publik, sigurinë, shëndetin ose moralin, sekretariati mund të importojë të gjitha mallrat dhe botimet e synuara për përdorim zyrtar nga ana e tij.

Neni 13

Sekretariati përjashtohet nga të gjitha taksat e tërthorta mbi botimet zyrtare që merr apo dërgon jashtë.

Neni 14

Mallrat që i përkasin sekretariatit nuk mund të nxirren jashtë përdorimit në Belgjikë, përveçse sipas kushteve të përcaktuara nga ligjet dhe rregullat belge.

Neni 15

Sekretariati nuk përjashtohet nga taksat dhe detyrimet që faktikisht janë vetëm tarifat për shërbimet publike.

Neni 16

Sekretariatit i garantohet liria e komunikimit për qëllimet e veta zyrtare. Korrespondenca e tij zyrtare është e paprekshme.

Neni 17

Pa cenuar detyrimet e Belgjikës që lindin nga traktatet me Bashkimin Europian dhe zbatimin e ligjeve dhe rregulloreve, kushtet dhe procedurat për zbatimin e neneve 8, 9, 10, 11, 12, 13 dhe 14 përcaktohen nga ministri përkatës i financave.

KREU II
POZICIONI LIGJOR I DREJTORIT DHE PERSONELIT

Neni 18

1. Drejtori dhe një anëtar tjetër i personelit, i cili zëvendëson drejtorin në rastin kur ai/ajo nuk është i/e pranishëm/e, gëzojnë imunitetet, privilegjet dhe lehtësitë që iu ofrohen pjesëtarëve të personelit diplomatik të misioneve diplomatike. Bashkëshortët dhe fëmijët e tyre të mitur, që jetojnë nën të njëjtën strehë, gëzojnë privilegjet që u jepen bashkëshortëve dhe fëmijëve të mitur të personelit diplomatik.

2. Lidhur me zbatimin e taksave mbi të ardhurat dhe taksat mbi kapitalin, elemente të të ardhurave ose të kapitalit të drejtorit dhe anëtarit të personelit, përmendur në paragrafin 1 të këtij neni, taksohen në vendet ku ata konsiderohen rezidentë në kohën e marrjes së detyrës, në përputhje me dispozitat e konventave për shmangien e taksimit të dyfishtë.

Neni 19

1. Personeli i sekretariatit gëzon:

a) imunitet ligjor për veprimet e kryera në cilësinë e tyre zyrtare, përfshirë fjalët e shkruara ose të folura; ky imunitet vlen edhe pasi ata janë larguar nga shërbimi;

b) paprekshmëri të të gjitha letrave dhe dokumenteve zyrtare.

2. Personeli i sekretariatit, si dhe bashkëshortët e tyre ligjorë dhe fëmijët e mitur nën varësinë e tyre, të cilët jetojnë nën të njëjtën strehë, gëzojnë përjashtim nga masat kufizuese të imigracionit dhe nga formalitetet e regjistrimit për të huajt. Ky përjashtim lejohet në përputhje me legjislacionin belg për këtë çështje.

3. Sekretariati njofton Shërbimin e Protokollit të Shërbimit Publik Federal të Marrëdhënieve me Jashtë për mbërritjen dhe largimin përfundimtar të personelit të saj dhe ofron gjithashtu një informacion konkret lidhur me stafin e vet, si më poshtë:

a) emrin dhe mbiemrin,

b) ditëlindjen dhe vendlindjen,

c) gjininë,

d) kombësinë,

e) adresën e përhershme të banimit (qytetin, rrugën, numrin),

f) gjendjen civile,

g) përbërjen familjare,

h) skemën e sigurimeve shoqërore të zgjedhur nga pjesëtari i personelit.

Shërbimi i Protokollit i Shërbimit Publik Federal të Marrëdhënieve me Jashtë njoftohet brenda dy javëve për çdo ndryshim të të dhënave të lartpërmendura.

Neni 20

1. Pa cenuar detyrimet e Belgjikës, që lindin nga traktatet me Bashkimin Europian dhe zbatimi i ligjeve dhe rregulloreve, anëtarët e personelit të sekretariatit, me përjashtim të anëtarëve të përmendur në nenin 18, gëzojnë të drejtën që, gjatë një periudhe 12-mujore pas marrjes për herë të parë të detyrës në Belgjikë, të importojnë ose blejnë mobilie dhe një makinë për përdorim personal në Belgjikë, duke u përjashtuar nga taksa e importit dhe tatimi mbi vlerën e shtuar (TVSH).

2. Ministri përkatës i financave përcakton kufijtë dhe kushtet e zbatimit të këtij neni.

Neni 21

Belgjika nuk është e detyruar t'u ofrojë shtetasve të saj apo banorëve të saj të përhershëm avantazhet, privilegjet dhe imunitetet që përcaktohen në kuadër të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 22

Në ushtrimin e funksioneve të tij zyrtare brenda sekretariatit, personeli i sekretariatit nuk është subjekt i legjislacionit belg për punësimin e punonjësve të huaj dhe për ushtrimin e veprimtarive profesionale të vetëpunësimit nga të huajt.

Neni 23

Sekretariati nxjerr një formular për të gjithë përfituesit, brenda 1 marsit të çdo viti, ku, përveç emrave dhe adresave, specifikohet masa e rrogave, pagave, sigurimet në rast dëmtimi, pensionet apo shpërblimet vjetore që u janë paguar atyre nga sekretariati gjatë vitit paraardhës.

Përveç kësaj, sekretariati i dërgon një kopje të këtij formulari përpara kësaj date administratës përgjegjëse fiskale të Belgjikës.

Neni 24

1. Anëtarët e personelit të sekretariatit, të cilët nuk janë shtetas të Belgjikës ose që nuk janë banorë të përhershëm në këtë vend dhe nuk ushtrojnë asnjë veprimtari fitimprurëse, përveç atyre të përcaktuara në funksionet e tyre, mund të zgjedhin të mbulohen nga skemat e sigurimeve shoqërore që zbatohen për anëtarët e personelit të sekretariatit, në përputhje me rregullat e përcaktuara nga këto skema. Anëtari i personelit duhet ta ushtrojë këtë të drejtë zgjedhjeje brenda dy javëve nga marrja e detyrës për herë të parë dhe duhet të njoftohet brenda së njëjtës periudhë kohore, në përputhje me nenin 19.3.

2. Sekretariati do të sigurojë mbulimin nga sistemi belg të sigurimeve shoqërore të anëtarëve të personelit që kanë shtetësi belge ose banim të përhershëm në vend, si dhe të anëtarëve të personelit të cilët nuk kanë zgjedhur asnjë prej skemave të mbrojtjes sociale të ofruara nga vetë sekretariati.

3. Sekretariati merr përsipër t'u garantojë anëtarëve të personelit të vet të vendosur në Belgjikë, të cilët janë mbuluar nga skemat e tij të sigurimeve shoqërore, si dhe bashkëshortëve dhe fëmijëve të mitur në varësinë e tyre që jetojnë nën të njëjtën strehë, siç përcaktohet në nenin 19.2, avantazhe të barasvlershme me ato të ofruara nga sistemi belg i sigurimeve shoqërore.

4. Punonjësit e rekrutuar nga sekretariati, të cilët nuk kanë një pozicion të përhershëm, do të mbulohen nga sistemi belg i sigurimeve shoqërore, duke marrë në konsideratë misionin dhe rregullat statutore të sekretariatit.

5. Belgjika mund të sigurojë nga Sekretariati kthimin e kostove që shoqërojnë çdo ndihmë me karakter social që mund të duhet t'iu ofrojë anëtarëve të personelit që punojnë në sekretariat, të cilët mbulohen nga skema e sigurimeve shoqërore që zbatohet për anëtarët e personelit të sekretariatit.

KREU III
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 25

Privilegjet dhe imunitetet u jepen anëtarëve të personelit të sekretariatit vetëm në interes të sekretariatit dhe jo për përfitimet e tyre personale. Drejtori i komisionit të përbashkët heq dorë, sipas rastit, nga i gjithë imuniteti i vet, sa herë që imuniteti pengon veprimtarinë e drejtësisë dhe kjo dorëheqje nuk dëmton funksionimin e duhur të sekretariatit.

Neni 26

Pa cenuar të drejtat që i janë dhënë sekretariatit dhe personelit të tij nga kjo Marrëveshje, Belgjika rezervon të drejtën të marrë të gjitha masat paraprake në interes të sigurisë së saj.

Neni 27

1. Personat që përmenden në nenin 18 dhe 19 nuk gëzojnë asnjë imunitet ligjor për shkeljet e trafikut rrugor apo dëmet e shkaktuara nga një automjet.

2. Sekretariati dhe personeli i tij veprojnë në përputhje me të gjitha detyrimet e përcaktuara në legjislacionin belg për sigurimet, për detyrimet civile, për përdorimin e automjetit.

Neni 28

Sekretariati dhe personeli i tij bashkëpunojnë gjatë gjithë kohës me autoritetet kompetente belge për të lehtësuar administrimin e duhur të drejtësisë, për të siguruar respektimin e rregullave të policisë dhe për të parandaluar kryerjen e ndonjë abuzimi në lidhje me imunitetet dhe privilegjet e përcaktuara në këtë Marrëveshje.

Neni 29

Sekretariati dhe personeli i tij veprojnë në përputhje me ligjet dhe rregullat belge dhe me vendimet e gjykatës që janë dhënë kundër tyre.

Neni 30

Belgjika nuk mban asnjë përgjegjësi ndërkombëtare të asnjë lloji për veprimtaritë e sekretariatit në territorin e saj, në lidhje me veprimet ose mosveprimet e sekretariatit ose personelit të tij ose mosveprimit në ushtrim të funksioneve të tyre.

Neni 31

1. Çdo konflikt pikëpamjesh në lidhje me zbatimin ose interpretimin e kësaj Marrëveshjeje, që

nuk mund të zgjidhet nëpërmjet bisedimeve të drejtpërdrejta midis Belgjikës dhe palëve të CEFTA-s, mund t'i dërgohet nga njëra prej palëve një gjykate arbitrazhi të përbërë prej tri vetash.

2. Belgjika dhe palët e CEFTA-s caktojnë një arbitrues secila.

3. Arbitruesi i tretë caktohet nga Belgjika dhe palët e CEFTA-s së bashku, me konsultim.

4. Arbitruesi i tretë është kryetari i Gjykatës së Arbitrazhit.

5. Në rast mosmarrëveshjeje për zgjedhjen e arbitruesit të tretë, ky arbitrues caktohet nga kryetari i Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë, me kërkesë nga Belgjika dhe palët e CEFTA-s.

6. Mosmarrëveshja paraqitet përpara gjykatës së arbitrazhit, pas aplikimit nga Belgjika ose palët e CEFTA-s.

7. Gjykata e arbitrazhit përcakton procedurat e saj.

KREU IV
DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

Neni 32

Kjo Marrëveshje është subjekt ratifikimi, pranimi ose miratimi nga palët, në përputhje me procedurat e tyre të brendshme kushtetuese dhe ligjore.

Instrumentet e ratifikimit, pranimit ose miratimit depozitohen në Qeverinë e Mbretërisë së Belgjikës (Shërbimi Publik Federal i Marrëdhënieve me Jashtë, Tregtisë së Jashtme dhe Bashkëpunimit Ndërkombëtar).

Kjo Marrëveshje hyn në fuqi ditën e tridhjetë pas datës së marrjes së instrumenteve të katër palëve nënshkruese të CEFTA-s, përveç Mbretërisë së Belgjikës, me kusht që të jenë respektuar formalitetet e brendshme që kërkohen për hyrjen në fuqi. Për palët e tjera të CEFTA-s, Marrëveshja hyn në fuqi në datat përkatëse të depozitimit të instrumentit të tyre të ratifikimit, pranimit ose miratimit.

Kjo Marrëveshje mund të rishikohet me kërkesën e përbashkët të Belgjikës dhe Komisionit të Përbashkët të palëve të CEFTA-s. Ndryshimet e kësaj Marrëveshjeje hyjnë në fuqi në përputhje me dispozitat paragrafëve të mësipërm.

Marrëveshja do të konsiderohet si e dhënë fund nga një palë e CEFTA-s, që nga data e tërheqjes së kësaj pale nga CEFTA.

Neni 33

Qeveria e Mbretërisë së Belgjikës është depozitarja e kësaj Marrëveshjeje.

Origjinali për palët e CEFTA-s do t'i dorëzohet Qeverisë së Mbretërisë së Belgjikës, depozitarja e kësaj Marrëveshjeje, e cila, më pas, u dërgon të gjitha palëve një kopje të vërtetuar dhe të verifikuar.

Në dëshmi sa më sipër, përfaqësuesit e Mbretërisë së Belgjikës dhe të Republikës së Shqipërisë, të Bosnjë-Hercegovinës, të Republikës së Kroacisë, të ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë, të Republikës së Moldavisë, të Republikës së Malit të Zi, të Republikës së Serbisë dhe Misionit të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë për llogari të Kosovës, në përputhje me Rezolutën 1244, e kanë nënshkruar këtë Marrëveshje në një kopje të vetme origjinale në gjuhën angleze.

Hartuar në Bruksel, më 26 qershor 2008

Për Mbretërinë e Belgjikës
(nënshkrimi)

Ky nënshkrim angazhon gjithashtu komunitetin gjermanishtfolës, komunitetin flamand, komunitetin francez, rajonin Walloon, rajonin flamand dhe rajonin e Brukselit-kryeqytet.

Për Republikën e Shqipërisë (nënshkrimi)

Për Bosnjë-Hercegovinën (nënshkrimi)

Për Republikën e Kroacisë (nënshkrimi)

Për Ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë (nënshkrimi)

Për Republikën e Moldavisë (nënshkrimi)

Për Malin e Zi (nënshkrimi)
Për Republikën e Serbisë (nënshkrimi)

Për Misionin e Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë në emër të Kosovës, në përputhje me Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara (nënshkrimi)

VENDIM
Nr.556, datë 28.5.2009

PËR CAKTIMIN E SHPËRBLIMIT DITOR PËR USHTARAKËT SHQIPTARË, TË DËRGUAR NË REPUBLIKËN E ÇADIT DHE REPUBLIKËN E AFRIKËS QENDRORE, NË KUADËR TË MISIONIT USHTARAK "MINURCAT", TË ORGANIZATËS SË KOMBEVE TË BASHKUARA

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr.10114, datë 9.4.2009 "Për miratimin e aktit normativ nr.1, datë 2.4.2009 të Këshillit të Ministrave "Për dërgimin e një kompanie të Forcave të Armatosura në Republikën e Çadit dhe në Republikën e Afrikës Qendrore, si kontribut i Republikës së Shqipërisë, në misionin "Minurcat", të Organizatës së Kombeve të Bashkuara", dhe të ligjit nr.10 025, datë 27.11.2008 "Për buxhetin e vitit 2009", me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpërblimi ditor për ushtarakët shqiptarë, të dërguar në Republikën e Çadit dhe Republikën e Afrikës Qendrore, në misionin "Minurcat" të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, të jetë 60 (gjashtëdhjetë) euro për çdo ditë qëndrimi në këtë mision. Trajtimi financiar të fillojë nga data e dërgimit me mision të kontingjentit ushtarak.
2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, në masën 1 020 600 (një milion e njëzet mijë e gjashtëqind) euro, të përballohen nga buxheti i vitit 2009, miratuar për Ministrinë e Mbrojtjes.
3. Ngarkohet Ministria e Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.558, datë 28.5.2009

PËR LEJIMIN E DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË REZERVAVE MATERIALE TË SHTETIT TË SHESË MAKINERITË DHE PAJISJET E FABRIKËS SË USHQIMEVE PËR FËMIJË "BABY FOOD"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1 të nenit 10 të ligjit nr.9900, datë 10.4.2008 "Për rezervat materiale të shtetit", me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Rezervave Materiale të Shtetit të shesë makineritë dhe pajisjet e fabrikës së ushqimeve për fëmijë "BABY FOOD", sipas vlerësimit të kryer nga

Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.

2. Ngarkohet Drejtori i Përgjithshëm i Rezervave Materiale të Shtetit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.560, datë 28.5.2009

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR KALIMASH-MORINË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private për interes publik", dhe të nenit 8 të ligjit nr.9836, datë 26.11.2007 "Për Buxhetin e Shtetit, të vitit 2008", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor Kalimash - Morinë.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, për sipërfaqen 384 (treqind e tetëdhjetë e katër) m², tokë/truall, me vlerë 1 012 224 (një milion e dymbëdhjetë mijë e dyqind e njëzet e katër) lekë, objekte, me vlerë 25 095 402.91 (njëzet e pesë milionë e nëntëdhjetë e pesë mijë e katërqind e dy pikë nëntëdhjetë e një) lekë, me një vlerë të përgjithshme shpronësimi 26 107 626.91 (njëzet e gjashtë milionë e njëqind e shtatë mijë e gjashtëqind e njëzet e gjashtë pikë nëntëdhjetë e një) lekë.

4. Shpenzimet procedurale, në vlerën 361 000 (treqind e gjashtëdhjetë e një mijë) lekë, të përballohen nga Drejtoria e Përgjithshme të Rrugëve.

5. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, 26 107 626.91 (njëzet e gjashtë milionë e njëqind e shtatë mijë e gjashtëqind e njëzet e gjashtë pikë nëntëdhjetë e një) lekë, të përballohet nga llogaria e veçantë e Ministrisë së Financave, në Bankën e Shqipërisë, "Fondi i shpronësimeve".

6. Shpronësimi të fillojë më 30.5.2009 dhe të përfundojë më 30.8.2009.

7. Pronarët e përmendur në listën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, për të cilët është bërë shënimi "Konfirmim nga ZRPP", të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin e plotë të pronësisë, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve. Për objektet, pronarët përveç dokumentacionit të pronësisë duhet të paraqesin edhe dokumentacionin teknik-ligjor.

8. Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve të bëjë likuidimin e pronarëve brenda afateve të përcaktuara në pikën 6 të këtij vendimi, në bazë të dokumentacionit të pronësisë. Për objektet, Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve të bëjë likuidimin e pronarëve në bazë të dokumentacionit teknik-ligjor.

9. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Ministria e Financave dhe Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E PUNËVE PUBLIKE, TRANSPORTIT DHE TELEKOMUNIKACIONIT
DREJTORIA E PËRGJITJSHME E RRUGËVE
SEKTORI I SHPRONËSIMEVE

LISTA EMËRORE E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN
NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR "KALIMASH-MORINË"

Nr.	Pronari			ZK	Nr. pas	Truall			Objekte Vlera/lekë	Totali lekë	Vendndodhja	Shënime
	Emri	Atësia	Mbiemri			Sip.m²	Çmimi m²	Vlera lekë				
1	Xhem	Maksut	Cenaj	1819	83/3	384	2636	1012224	2948401	3960625	Gostil	Konfirmuar nga ZRPP
2	Haxhi	Avni	Matmuja	2912	304/2/34				4995454.77	4995454.77	Perbreg	Konfirmuar nga ZRPP
3	Tafil		Oruçi	1543	191/2				2697028.23	2697028.23	Lagjja Drinas	Konfirmuar nga ZRPP
4	Xhemali	Ajet	Brahaj	1543	193/12				2265619.09	2265619.09	Lagjja Drinas	Konfirmuar nga ZRPP
5	Ajet	Xhem	Brahaj	1543	193/4				2438762.63	2438762.63	Lagjja Drinas	Konfirmuar nga ZRPP
6	Hajdin	Dan	Istrefi	1543	192/2				362554.13	362554.13	Lagjja Drinas	Konfirmuar nga ZRPP
7	Sadik	Shuaip	Dulla	1543	192/8				2180377.31	2180377.31	Lagjja Drinas	Konfirmuar nga ZRPP
8	Han	Shuaip	Dulla	1543	192/3				2180377.31	2180377.31	Lagjja Drinas	Konfirmuar nga ZRPP
9	Fatmir	Shuaip	Dulla	1543	192/9				2198949.56	2198949.56	Lagjja Drinas	Konfirmuar nga ZRPP
10	Musa	Shuaip	Dulla	1543	192/4				2827878.88	2827878.88	Lagjja Drinas	Konfirmuar nga ZRPP
	TOTALI					**384**		**1012224**	**25095402.91**	**26107626.91**		

VENDIM
Nr.561, datë 28.5.2009

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.483, DATË 29.7.1996 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR DHËNIEN ME QIRA TË TRUALLIT, KU ËSHTË NDËRTUAR FSHATI I FËMIJËVE, NË TIRANË"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr.9967, datë 27.7.2008 "Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit, nr.4, datë 9.7.2008 të Këshillit të Ministrave "Për privatizimin dhe dhënien në përdorim shoqërive tregtare dhe institucioneve shtetërore, të ndërmarrjeve apo objekteve të veçanta, mjeteve kryesore dhe mjeteve të xhiros së këtyre ndërmarrjeve", me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në pikën 1 të vendimit nr.483, datë 29.7.1996 të Këshillit të Ministrave, afati "për 20 vjet" të bëhet "për 49 vjet".

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.562, datë 28.5.2009

PËR HAPJEN E PROGRAMIT TË RI TË STUDIMIT "MASTER I NIVELIT TË DYTË", PRANË SHKOLLËS SË LARTË UNIVERSITARE PRIVATE "JUSTINIANI I"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 4, pika 2, 43, 44 e 45 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e shkollës së lartë universitare private "Justiniani I", me seli në Tiranë, për hapjen e programit të studimit "Master i nivelit të dytë" në shkencat juridiko-penale.

2. Programi i studimit "Master i nivelit të dytë" do të jetë program studimi i ciklit të tretë, në plotësimin e të paktën 60 krediteve. Në përfundim të programit të studimit do të lëshohet diplomë "Master i nivelit të dytë", (MND), në shkenca juridiko-penale.

3. Ngarkohet shkolla e lartë universitare private "Justiniani I" që, për programin e studimit, të sigurojë, nëpërmjet marrëdhënieve kontraktuale, zhvillimin e disa prej disiplinave kryesore formuese të specialitetit, nga një personel akademik, me kualifikimin e nevojshëm dhe sipas specialitetit.

4. Shkolla e lartë universitare private "Justiniani I" do ta fillojë veprimtarinë mësimore për programin e studimit, të përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi, pasi të ketë marrë, jo më vonë se dy javë para fillimit të vitit akademik, lejen përkatëse nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës.

Ministri e lëshon lejen pasi vlerëson se institucioni mësimor ka përmbushur angazhimet e deklaruara, në përputhje me udhëzimin e tij për këtë qëllim.

5. Ndryshimet në vendndodhje, forma studimi, plane dhe programe, si dhe elemente të tjera, të miratuara, bëhen pas miratimit nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

6. Shkolla e lartë universitare private "Justiniani I" duhet t'i nënshtrohet procesit të akreditimit institucional dhe të këtij programi studimi, brenda afateve të përcaktuara në ligjin në fuqi.

7. Shkolla e lartë universitare private "Justiniani I", pas marrjes së lejes përkatëse për

programet e ciklit të tretë, nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës, strukturohet si universitet.

8. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës për kontrollin periodik të ligjshmërisë në institucion dhe për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.563, datë 28.5.2009

PËR HAPJEN E PROGRAMEVE TË REJA TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË, TË DYTË DHE "MASTER I NIVELIT TË PARË", PRANË SHKOLLËS SË LARTË UNIVERSITARE, PRIVATE, "KRISTAL"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 4, pika 2, 43, 44 e 45 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e shkollës së lartë universitare, private, "Kristal", Tiranë, për hapjen e programeve të studimit të ciklit të parë, në formën e studimeve me kohë të plotë, në fushat:

a) Shëndet publik;
b) Laborant mjekësor;
c) Sociologji.

2. Kohëzgjatja e programeve të studimit të ciklit të parë të jetë 3 vite akademike. Në përfundim të programeve të studimeve lëshohet diploma e nivelit të parë (DNP) në:

a) Shëndet publik;
b) Laborant mjekësor;
c) Sociologji.

3. Lejimin e shkollës së lartë universitare, private, "Kristal", Tiranë, për hapjen e programeve të studimit të ciklit të dytë, në formën e studimeve me kohë të plotë, në fushat:

a) E drejtë civile;
b) Marrëdhënie ndërkombëtare.

4. Kohëzgjatja normale e programeve të studimit të ciklit të dytë të jetë 2 vite akademike, me plotësimin, së paku, të 120 krediteve. Në përfundim të këtyre programeve të studimit lëshohet, përkatësisht, diplomë e nivelit të dytë (DND) në:

a) E drejtë civile.
b) Marrëdhënie ndërkombëtare.

5. Ngarkohet shkolla e lartë universitare, private, "Kristal", që, për çdo program studimi, të sigurojë, nëpërmjet marrëdhënieve kontraktuale, zhvillimin e disa prej disiplinave kryesore formuese të specialitetit, me kualifikimin e nevojshëm.

6. Lejimin e shkollës së lartë universitare, private, "Kristal", Tiranë, për hapjen e programit të studimit "Master i nivelit të parë" në:

a) Shëndet publik dhe menaxhim spitalor.

7. Programi i studimit "Master i nivelit të parë" është pjesë e studimeve të ciklit të dytë, me, së paku, plotësimin e 60 krediteve. Në mbarim të programit të studimit lëshohet diplomë "Master i nivelit të parë (MNP) në "Shëndet publik dhe menaxhim spitalor".

8. Shkolla e lartë universitare, private, "Kristal", do ta fillojë veprimtarinë mësimore për programet e studimit të përcaktuara në pikat 1, 3 e 6 të këtij vendimi, pasi të ketë marrë lejen përkatëse nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës, por jo më vonë se dy javë para fillimit të vitit akademik.

Ministri e lëshon lejen pasi vlerëson se institucioni mësimor ka përmbushur angazhimet e deklaruara, në përputhje me udhëzimin e tij për këtë qëllim.

9. Ndryshimet në vendndodhje, plane, forma studimi dhe programe, si dhe në elemente të tjera, të miratuara, bëhen pas miratimit nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

10. Shkolla e lartë universitare, private, "Kristal", duhet t'u nënshtrohet procesit të akreditimit institucional dhe këtyre programeve të studimit, brenda afateve të përcaktuara në ligjin në fuqi.

11. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës për kontrollin periodik të ligjshmërisë në institucion dhe për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.564, datë 28.5.2009

PËR HAPJEN E PROGRAMEVE TË REJA TË STUDIMIT "MASTER I NIVELIT TË DYTË", PRANË SHKOLLËS SË LARTË UNIVERSITARE, PRIVATE "UNIVERSITETI MARIN BARLETI"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 4, pika 2, 43, 44 e 45 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e shkollës së lartë universitare, private "Universiteti Marin Barleti", Tiranë, për hapjen e programeve të studimit "Master i nivelit të dytë" në:

a) Shkenca politike, me profile:
   i) Lidership;
   ii) Administrim publik.
b) Komunikim, me profile:
   i) Gazetari ekonomike;
   ii) Komunikim publik.
c) Administrim biznesi, me profile:
   i) Financë-kontabilitet;
   ii) Marketing dhe menaxhim operacionesh;
   iii) Shërbime bankare dhe financiare;
   iv) Prona të paluajtshme dhe sigurimi;
   v) Lidership dhe menaxhim burimesh njerëzore.
ç) Shkenca juridike, me profile:
   i) E drejtë publike;
   ii) E drejtë biznesi.

2. Programet e studimit "Master i nivelit të dytë" të jenë programe studimi të ciklit të tretë, në plotësimin e, të paktën, 60 krediteve. Në mbarim të programeve të studimit lëshohet diplomë "Master i nivelit të dytë" (MND) në:

a) Shkenca politike, me profile:
   i) Lidership;
   ii) Administrim publik.
b) Komunikim, me profile:
   i) Gazetari ekonomike;
   ii) Komunikim publik.
c) Administrim biznesi, me profile:

i) Financë-kontabilitet;
ii) Marketing dhe menaxhim operacionesh;
iii) Shërbime bankare dhe financiare;
iv) Prona të paluajtshme dhe sigurimi;
v) Lidership dhe menaxhim burimesh njerëzore.

ç) Shkenca juridike, me profile:
i) E drejtë publike;
ii) E drejtë biznesi.

3. Shkolla e lartë universitare, private, "Universiteti Marin Barleti" ta fillojë veprimtarinë mësimore për programet e studimit, të përcaktuara në pikën 1 të këtij vendimi, pasi të ketë marrë lejen përkatëse nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës, por jo më vonë se dy javë para fillimit të vitit akademik.

Ministri e lëshon lejen pasi vlerëson se institucioni mësimor ka përmbushur angazhimet e deklaruara, në përputhje me udhëzimin e tij për këtë qëllim.

4. Ndryshimet në vendndodhje, plane, forma studimi dhe programe, si dhe në elemente të tjera, të miratuara, bëhen pas miratimit nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

5. Shkolla e lartë universitare, private, "Universiteti Marin Barleti" duhet t'u nënshtrohet procesit të akreditimit institucional dhe këtyre programeve të studimit, brenda afateve të përcaktuara në ligjin në fuqi.

6. Shkolla e lartë universitare, private, "Universiteti Marin Barleti", pas marrjes së lejes përkatëse nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës, për hapjen e programeve të ciklit të tretë, të strukturohet si universitet.

7. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës për kontrollin periodik të ligjshmërisë në institucion dhe për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.566, datë 28.5.2009

PËR PJESËMARRJEN E FORCAVE USHTARAKE TË HUAJA NË STËRVITJEN E PËRBASHKËT "ADRION LIVEX-09", NË TERRITORIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës "b" të pikës 1 të nenit 14 të ligjit nr.9363, datë 24.3.2005 "Për mënyrën dhe procedurat e vendosjes dhe kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe për dërgimin e forcave ushtarake shqiptare jashtë vendit", me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pjesëmarrjen e 200 (dyqind) forcave ushtarake të huaja në stërvitjen e përbashkët, të koduar "ADRION LIVEX-09", që do të zhvillohet në hapësirën detare të Republikës së Shqipërisë dhe ujërat ndërkombëtare, nga data 7 deri 12 qershor 2009.

2. Ngarkohet Ministria e Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi, duke bërë publikimin e zonës detare, ku do të zhvillohet stërvitja, nëpërmjet njoftimit të organeve kompetente, që veprojnë në Portin e Durrësit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.567, datë 28.5.2009

PËR NJË SHTESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2009, MIRATUAR PËR MINISTRINË E EKONOMISË, TREGTISË DHE ENERGJETIKËS, PËR QENDRËN KOMBËTARE TË LICENCIMIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 10 të ligjit nr.9000, datë 31.1.2003 "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave", të nenit 29 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ligjit nr.10025, datë 27.11.2008 "Për buxhetin e vitit 2009" dhe të ligjit nr.10081, datë 23.2.2009, "Për licencat dhe autorizimet në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, për Qendrën Kombëtare të Licencimit, në buxhetin e miratuar për vitin 2009, në programin "Mbështetje për zhvillim ekonomik", t'i shtohet fondi 34 000 000 (tridhjetë e katër milionë) lekë, përkatësisht:

- 21 000 000 (njëzet e një milionë) lekë, zëri "Shpenzime personeli";
- 13 000 000 (trembëdhjetë milionë) lekë, zëri "Shpenzime korente".

2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i buxhetit të vitit 2009.

3. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.568, datë 28.5.2009

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR "RRUGA E VOSKOPOJËS, KORÇË"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", dhe të nenit 8 të ligjit nr.9836, datë 26.11.2007 "Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2008", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “Rruga e Voskopojës, Korçë”.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, për sipërfaqen 63 (gjashtëdhjetë e tre) m², tokë/truall, me vlerë 99 225 (nëntëdhjetë e nëntë mijë e dyqind e njëzet e pesë) lekë, dhe për sipërfaqen 4819 (katër mijë e tetëqind e nëntëmbëdhjetë) m², tokë/arë, me vlerë 602 349 (gjashtëqind e dy mijë e treqind e dyzet e nëntë) lekë, me një vlerë të përgjithshme shpronësimi 701 574 (shtatëqind e një mijë e pesëqind e shtatëdhjetë e katër) lekë.

4. Shpenzimet procedurale, në vlerën 329 500 (treqind e njëzet e nëntë mijë e pesëqind) lekë, të përballohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve.

5. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, 701 574 (shtatëqind e një mijë e pesëqind e shtatëdhjetë e katër) lekë, të përballohet nga llogaria e veçantë e Ministrisë së Financave, në Bankën e Shqipërisë “Fondi i shpronësimeve”.

6. Shpronësimi të fillojë më 1.6.2009 dhe të përfundojë më 31.8.2009.

7. Pronarët e përmendur në listën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, për të cilët është bërë shënimi “Konfirmim nga ZRPP”, të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin e plotë të pronësisë, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.

8. Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve të bëjë likuidimin e pronarëve sipas listës, që i bashkëlidhet këtij vendimi, në bazë të dokumentacionit të pronësisë, që do t’i vihet në dispozicion nga pronarët.

9. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Ministria e Financave dhe Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E PUNËVE PUBLIKE, TRANSPORTIT DHE TELEKOMUNIKACIONIT
DREJTORIA E PËRGJITJSHME E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE
DREJTORIA JURIDIKE
SEKTORI I SHPRONËSIMEVE

LISTA E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR "RRUGA VOSKOPOJË"
Komuna Voskopojë Fshati Gjonomadh Z.K.1760

N.	Emri	Atësia	Mbiemri	Z.K.	Nr. pasurisë	Lloji i Pasurisë						Vlera Totale/lekë	Shënime
						ARË			TRUALL				
						Sip.m²	Çmimi	Vlera	Sip.m²	Çmimi	Vlera		
1	Osman	Etem	Stopani	1760	1004	993	89.8	89171.4				89171.4	Konfirmim nga ZVRPP
2	Nazmi	Istref	Metellari	1760	656/4	64	89.8	5747.2				5747.2	Konfirmim nga ZVRPP
3	Ladin	Amet	Metellari	1760	656/3	196	89.8	17600.8				17600.8	Konfirmim nga ZVRPP
4	Afrim	Xhafer	Selimllari	1760	656/2	21	89.8	1885.8				1885.8	Konfirmim nga ZVRPP
5	Seit	Ramadan	Xhaxhamani	1760	1088/8	311	89.8	27927.8				27927.8	Konfirmim nga ZVRPP
6	Faik	Asllan	Allisha	1760	1094/57	347	89.8	31160.6				31160.6	Konfirmim nga ZVRPP
7	Pajazit+Sami		Xhindi	1760	1094/48	507	89.8	45528.6				45528.6	Konfirmim nga ZVRPP
8	Ramadan	Syrja	Allisha	1760	1094/47	171	89.8	15355.8				15355.8	Konfirmim nga ZVRPP
9	Faik		Allisha	1760	1094/34	203	89.8	18229.4				18229.4	Konfirmim nga ZVRPP
10	Islam	Syrja	Allisha	1760	1094/33	145	89.8	13021				13021	Konfirmim nga ZVRPP
						2958		**265628.4**				**265628.4**	

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E PUNËVE PUBLIKE, TRANSPORTIT DHE TELEKOMUNIKACIONIT

DREJTORIA E PËRGJITJSHME E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE
DREJTORIA JURIDIKE
SEKTORI I SHPRONËSIMEVE

LISTA E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR "RRUGA VOSKOPOJË"
Komuna Voskop Fshati Voskop Z.K.3818

N.	Emri	Atësia	Mbiemri	Z.K.	Nr. pasurisë	Lloji i Pasurisë						Vlera Totale/lekë	Shënime
						ARË			TRUALL				
						Sip.m²	Çmimi	Vlera	Sip.m²	Çmimi	Vlera		
1	Ramadan		Myrdinasi	3818	94/10	42	268.6	11281.2				11281.2	Konfirmim nga ZVRPP
2	Engjellusha		Nurçe	3818	94/9	35	268.6	9401				9401	Konfirmim nga ZVRPP
3	Ramadan		Myrdinasi	3818	94/8	15	268.6	4029				4029	Konfirmim nga ZVRPP
4	Fiqiri		Myrdinasi	3818	94/7	27	268.6	7252.2				7252.2	Konfirmim nga ZVRPP
5	Seit		Nurçe	3818	46/33	123	268.6	33037.8				33037.8	Konfirmim nga ZVRPP
6	Kastriot		Sejdolli	3818	46/34	170	268.6	45662				45662	Konfirmim nga ZVRPP
7	Shpëtim		Nurçe	3818	46/32	223	268.6	59897.8				59897.8	Konfirmim nga ZVRPP
8	Kudret		Lemellari	3818	46/31	168	268.6	45124.8				45124.8	Konfirmim nga ZVRPP
						803		**215685.8**				**215685.8**	

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E PUNËVE PUBLIKE, TRANSPORTIT DHE TELEKOMUNIKACIONIT
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

DREJTORIA JURIDIKE
SEKTORI I SHPRONËSIMEVE

LISTA E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR “RRUGA VOSKOPOJË”
Komuna Voskopojë Fshati Voskopojë Z.K.3819

N.	Emri	Atësia	Mbiemri	Z.K.	Nr. pasurisë	Lloji i pasurisë						Vlera Totale/lekë	Shënime
						ARË			TRUALL				
						Sip.m²	Çmimi	Vlera	Sip.m²	Çmimi	Vlera		
1	Nisi	Kosta	Kallulla	3819	1035/1		114.4		5	1575	7875	7875	Konfirmim nga ZVRPP
2	Ilia	Koçi	Bardhi	3819	1035/2				12	1575	18900	18900	Konfirmim nga ZVRPP
3	Baki	Hariz	Shalca	3819	1037/1	47	114.4	5376.8		1575		5376.8	Konfirmim nga ZVRPP
4	Marjanthi		Qosa+Bp.	3819	1037/20		114.4		46	1575	72450	72450	Konfirmim nga ZVRPP
5	Jovan	Llambi	Paco	3819	1037/9	47	114.4	5376.8		1575		5376.8	Konfirmim nga ZVRPP
6	Kristaq	Sandri	Bani	3819	1037/10	200	114.4	22880		1575		22880	Konfirmim nga ZVRPP
7	Anton+Gjergji		Vani	3819	992/2	38	114.4	4347.2		1575		4347.2	Konfirmim nga ZVRPP
8	Meladin		Beqo	3819	1113/23	82	114.4	9380.8		1575		9380.8	Konfirmim nga ZVRPP
9	Guri	Vangjo	Fili	3819	1113/19	50	114.4	5720		1575		5720	Konfirmim nga ZVRPP
10	Flamur		Cukali	3819	1113/18	43	114.4	4919.2		1575		4919.2	Konfirmim nga ZVRPP
11	Bajram	Rakip	Nazemllari	3819	1113/7	183	114.4	20935.2		1575		20935.2	Konfirmim nga ZVRPP
12	Sotiraq	Ndrio	Bani	3819	1113/8	104	114.4	11897.6		1575		11897.6	Konfirmim nga ZVRPP
13	Jonus		Bezhani	3819	1120/4	30	114.4	3432		1575		3432	Konfirmim nga ZVRPP
14	Fatjon	Mersin	Bezhani	3819	1120/3	64	114.4	7321.6		1575		7321.6	Konfirmim nga ZVRPP
15	Raimonda		Zguri	3819	1120/2	170	114.4	19448		1575		19448	Konfirmim nga ZVRPP
						1058			**63**				
								121035.2			**99225**	**220260.2**	

VENDIM
Nr.14, datë 3.6.2009

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Vladimir Kristo	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Fehmi Abdiu	Anëtar i " "
Kujtim Puto	Anëtar i " "
Xhezair Zaganjori	Anëtar i " "
Petrit Plloçi	Anëtar i " "
Vitore Tusha	Anëtare e " "
Sokol Berberi	Anëtar i " "
Admir Thanza	Anëtar i " "
Sokol Sadushi	Anëtar i " "

me sekretare Brunilda Bara, në datën 17.3.2008, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore pa pjesëmarrjen e palëve, në bazë të dokumenteve të paraqitura, çështjen me nr.3 Akti që i përket:

KËRKUES: Drejtoria e Përgjithshme e Doganave

SUBJEKT I INTERESUAR: Shoqëria "Stefa" sh.p.k. Vlorë

OBJEKTI: Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë i vendimit nr.00-2007-1470 (1181), datë 18.10.2007, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 16, 42, 43, 131, shkronja "f" dhe 134, shkronja "g" të Kushtetutës.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Sokol Sadushi; u njoh me parashtrimet e paraqitura paraprakisht prej kërkuesit që kërkoi pranimin e kërkesës dhe e shqyrtoi çështjen mbi bazë dokumentesh,

VËREN:

I

1. Dega e doganës Vlorë, në bazë të titujve ekzekutivë nr.234, datë 10.9.2009 dhe nr.244, datë 10.11.2002 në lidhje me borxhin doganor të papaguar nga subjekti i interesuar, shoqëria "Stefa" sh.p.k., ka kërkuar ekzekutimin e tyre.

Shoqëria "Stefa" sh.p.k. i ka kundërshtuar gjyqësisht si të pavlefshëm titujt ekzekutivë, në shumat 68.480.224 lekë dhe 14.517.131 lekë, me pretendimin se janë të paqena.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me vendimin nr.1609, datë 8.10.2003, ka rrëzuar padinë e subjektit të interesuar, shoqërisë "Stefa", sh.p.k.

Mbi ankimin e subjektit të interesuar, Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr.9, datë 28.1.2004, ka ndryshuar vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë dhe i ka konstatuar të pavlefshëm titujt ekzekutivë për borxhin doganor të subjektit të interesuar.

Kundër vendimit të Gjykatës së Apelit Vlorë ka paraqitur rekurs kërkuesi. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr.736, datë 28.4.2005, ka vendosur pushimin e gjykimit të çështjes, me arsyetimin se "rekursi, meqenëse është dorëzuar jashtë afatit, duhet konsideruar se mungon".

Gjykata Kushtetuese, e investuar me kërkesë të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave (Dega Vlorë), me vendimin nr.22, datë 26.7.2006, ka vendosur: "Shfuqizimin si antikushtetues të vendimit nr.736, datë 28.4.2005 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë dhe e ka dërguar çështjen për shqyrtim në atë gjykatë".

Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, pasi e ka rimarrë në shqyrtim këtë çështje, me vendimin nr. 00-2007-1470 (1181), datë 18.10.2007, ka vendosur: "Pushimin e gjykimit në Gjykatën e Lartë të çështjes civile...", duke arsyetuar se, "...rekursi është paraqitur jashtë afatit e si rrjedhojë, duhet konsideruar se ai mungon".

2. ***Kërkuesi, në kërkesën drejtuar Gjykatës Kushtetuese,*** ka pretenduar se Kolegji Civil i

Gjykatës së Lartë, nëpërmjet vendimit nr. 00-2008-146, datë 1.2.2008, ka zhvilluar një proces të parregullt gjyqësor, për arsye se:

- në kundërshtim me nenin 132 të Kushtetutës që përcakton fuqinë detyruese dhe përfundimtare të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese, për zgjidhjen e çështjes konkrete, ka mënjanuar zbatimin e vendimit nr. 22, datë 26.7.2006 të Gjykatës Kushtetuese;

- duke e konsideruar rekursin jashtë afatit ligjor, i ka cenuar të drejtën kushtetuese të ankimit në një gjykatë më të lartë, parashikuar nga neni 43 i Kushtetutës. Në këtë kontekst, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë i ka cenuar edhe të drejtën për t'iu drejtuar gjykatës, parashikuar nga neni 42 i Kushtetutës.

3. Përfaqësuesi i subjektit të interesuar nuk ka prezantuar me shkrim përpara Gjykatës Kushtetuese qëndrimin e tij mbi kërkesën e paraqitur.

II

1. Kjo kërkesë përpara Gjykatës Kushtetuese (Gjykata) është ngritur nga një subjekt juridik publik, në kuptim të moszbatimit të standardit kushtetues të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, parashikuar nga neni 131 shkronja "f" të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

Gjykata vlerëson paraprakisht se, në respekt të rregullimeve të parashikuara nga nenet 131, shkronja "f"; 134, shkronja "g", dhe 16 të Kushtetutës, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave është një subjekt që legjitimohet për t'iu drejtuar kësaj gjykate, sepse nisma për një gjykim kushtetues nuk kushtëzohet nga karakteri i personit juridik, publik a privat, por nga natyra e pretendimeve që parashtrohen. Kërkuesi, si palë e paditur në gjykim, ka pretenduar cenimin e së drejtës për t'iu drejtuar gjykatës, si një nga elementet e së drejtës për një proces të rregullt ligjor.

Në jurisprudencën e saj, Gjykata ka bërë dallimin e legjitimimit të personave juridikë publikë, që pretendojnë cenime të të drejtave themelore substanciale nga legjitimimi i subjekteve të së drejtës publike, që pretendojnë cenime të të drejtave themelore procedurale. E drejta për akces në gjykatë, si një e drejtë e natyrës procedurale, duhet të respektohet dhe të përdoret nga çdo subjekt që konsiderohet palë në një proces, dhe që preket në mënyrë të drejtpërdrejtë prej tij. Një e drejtë e tillë nuk mund të cenohet, sepse duke qenë një element i së drejtës në tërësi dhe që rrjedh nga thelbi i shtetit të së drejtës, garanton barazinë e palëve në procesin gjyqësor. Për këtë arsye ankimi në Gjykatën Kushtetuese për shkeljen e së drejtës për një proces të rregullt ligjor nuk mund të kufizohet për asnjë subjekt, përfshirë këtu edhe personat juridikë publikë (*shih vendimin nr. vendimin nr. 22, datë 26.07.2006 të Gjykatës Kushtetuese)*.

III

1. Argumentet kryesore për antikushtetutshmërinë e vendimit gjyqësor kërkuesi i ka përqendruar në dispozitat e Kushtetutës që lidhen me moszbatimin e vendimit të Gjykatës Kushtetuese (neni 132), me cenimin e së drejtës për t'u ankuar në një gjykatë më të lartë (neni 43) dhe me mohimin e së drejtës për t'iu drejtuar gjykatës (neni 42).

2. Në nenin 43 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë parashikohet se: "Kushdo ka të drejtë të ankohet kundër një vendimi gjyqësor në një gjykatë më të lartë, përveçse kur në Kushtetutë parashikohet ndryshe". Gjykata thekson se e drejta e ankimit në kuptim të nenit 43 të Kushtetutës, duhet kuptuar si mundësi e çdo individi për të pasur mjete të caktuara procedurale për të kundërshtuar, në një gjykatë më të lartë, vendimin e dhënë ndaj tij nga një gjykatë më e ulët. Pra, me Kushtetutë, kujtdo i garantohet e drejta për t'u ankuar, të paktën një herë, kundër çdo vendimi gjyqësor të dhënë ndaj tij. Kjo garanci e rëndësishme kushtetuese është një tejkalim pozitiv krahasuar me standardet që ofron në këtë drejtim Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut.

Në një tjetër dispozitë kushtetuese, në nenin 42, pika 2, parashikohet: "Kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe interesave të tij kushtetues dhe ligjorë, ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj".

Gjykata vlerëson se, ndonëse neni 42 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe neni 6 i Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut nuk parashikojnë shprehimisht të drejtën për të pretenduar mjete ankimi kundër vendimeve gjyqësore, ato i sigurojnë personat që i drejtohen ligjit për

gëzimin përpara gjykatave të garancive themelore të procesit të rregullt ligjor. E drejta për t'iu drejtuar gjykatave nuk përfshin vetëm të drejtën për të hapur një proces, por edhe të drejtën për të pasur, nga ana e gjykatës, një zgjidhje përfundimtare në lidhje me mosmarrëveshjen. Në një shoqëri demokratike, e drejta për administrim të mirë të drejtësisë zë një vend të dallueshëm dhe asnjë interpretim i ngushtë i nenit 42 të Kushtetutës dhe i nenit 6 të KEDNJ-së nuk përputhet me qëllimet dhe objektin e tyre. Administrimi i mirë i drejtësisë fillon me garancinë që një individ të ketë akses në gjykatë për t'i siguruar atij të gjitha aspektet e një forme gjyqësore të shqyrtimit të çështjes. Aksesi në gjykatë duhet të jetë substantiv dhe jo thjesht formal. "Aksesi në gjykatë nuk është i kufizuar në qoftë se pala e përfaqësuar nga avokati ka mundësi të ngrejë padi lirisht, të paraqesë argumente në mbështetje të saj si dhe të apelojë vendimet e dhëna" (*Shih vendimin "Mateos e Silva Lda dhe të tjerë kundër Portugalisë, i Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut, i datës 16.09.1996 RJD 1996-IV, par 64*).

Gjykata rithekson se e drejta për t'iu drejtuar gjykatës është një nga aspektet e së drejtës për gjykim, e sanksionuar në nenin 42 të Kushtetutës. Mohimi i së drejtës për t'iu drejtuar gjykatës dhe për të marrë një përgjigje përfundimtare prej saj lidhur me pretendimet e ngritura, përbën cenim të së drejtës themelore për një proces të rregullt ligjor, parashikuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i Konventës Europiane (*shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.7, datë 11.03.2008*). Nga kjo pikëpamje, Gjykata vlerëson se mohimi i të drejtës për tu ankuar mbi çështje të së drejtës, duke u konsideruar si një sanksion i rëndë ndaj të drejtës për t'iu drejtuar gjykatave, nuk analizohet i lidhur me nenin 43, por sipas konceptit kushtetues të parashikuar nga neni 42 i Kushtetutës.

IV

1. Kërkuesi ka argumentuar se e drejta për t'iu drejtuar gjykatës i është cenuar për shkak të moszbatimit nga Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë të vendimit nr.22, datë 26.7.2006 të Gjykatës Kushtetuese, nëpërmjet të cilit është zgjidhur përfundimisht pretendimi i sipërcituar. Duke refuzuar të zbatojë këtë vendim, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka shkelur rregullimin kushtetues, se "vendimet e Gjykatës Kushtetuese kanë fuqi detyruese të përgjithshme dhe janë përfundimtare" (neni 132 i Kushtetutës).

Me vendimin nr.22, datë 26.7.2006, në çështjen me kërkues Drejtoria e Përgjithshme e Doganave kundër subjektit të interesuar Shoqëria "Stefa" Sh.p.k., Gjykata ka konkluduar se Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, duke pushuar çështjen me arsyetimin se mungon ankimi, i ka cenuar kërkuesit të drejtën e akcesit në gjykatë. Këtë konkluzion përfundimtar, të argumentuar në vendimin e Gjykatës, me anë të të cilit është konstatuar cenimi i Së drejtës për një proces të rregullt ligjor, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë e ka shmangur gjatë zgjidhjes së çështjes konkrete. Me vendimin nr. 00-2007-1470 (1181), datë 18.10.2007, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka mbajtur të njëjtin qëndrim si në vendimin e shfuqizuar më parë nga Gjykata si antikushtetues, duke arsyetuar se "*rekursi është paraqitur jashtë afatit e si rrjedhojë, duhet konsideruar se ai mungon*".

2. Gjykata thekson se është e domosdoshme të analizojë pretendimin e kërkuesit për parregullsinë e procesit gjyqësor në Kolegjin Civil të Gjykatës së Lartë, në drejtim të ndikimit që mund të ketë pasur moszbatimi i vendimit nr.22, datë 26.7.2006 mbi ushtrimin e së drejtës për akces në gjykatë dhe realizimin prej kërkuesit të së drejtës për t'u mbrojtur.

Nenet 124, 132 dhe 145/2 të Kushtetutës shprehen qartësisht në lidhje me forcën detyruese të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese mbi të gjitha organet kushtetuese, autoritetet publike dhe gjykatat. Zbatimi i detyrueshëm i vendimeve të Gjykatës Kushtetuese është detyrim kushtetues; ato kanë fuqi detyruese të përgjithshme dhe janë përfundimtare. Ato përbëjnë jurisprudencë kushtetuese dhe për rrjedhojë, kanë efektet e forcës së ligjit (*shih vendimin nr.5, datë 7.2.2001 të Gjykatës Kushtetuese*). Asnjë organ tjetër me përjashtim të vetë Gjykatës (dhe kjo lidhet me ndryshimin e praktikës, apo rishikimin e Kushtetutës), nuk mund të mos pranojë i zbatojë ato. Lënia në vlerësimin e organeve të tjera të vendimeve kushtetuese krijon precedentin e rrezikshëm për t'i mohuar këtij organi funksionin e garantit të Kushtetutës. Roli i Gjykatës qëndron pikërisht në fuqinë detyruese të vendimeve të saj. Formulimi që i ka dhënë Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë fuqisë detyruese të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese përcakton autoritetin e këtij organi dhe është e vetmja mënyrë e pranueshme për zgjidhjen e drejtë dhe përfundimtare të çështjeve me natyrë kushtetuese.

Ky efekt detyrues ka të bëjë si me pjesën urdhëruese, ashtu edhe me pjesën arsyetuese të vendimit. Arsyetimi që përdor Gjykata në vendimet e saj buron nga autoriteti i saj për të thënë fjalën e fundit në çështjet, për të cilat të tjerët tashmë janë shprehur. Në respekt të doktrinës dhe të

jurisprudencës kushtetuese, Gjykata thekson se efekti detyrues shtrihet mbi argumentetet thelbësore të vendimit të saj që përbëjnë edhe *ratio decidendi*, eliminimi i të cilave do ta bënte vendimin, në tërësinë e tij, të pakuptimtë (*shih vendimet BVerfGE 1, p. 14 dhe BVerfGE 20, p. 56 të Gjykatës Kushtetuese Federale Gjermane*). Ndikimi i padiskutueshëm i vendimeve të Gjykatës është i tillë që iu imponon të gjithë organeve shtetërore, duke mos përjashtuar as gjykatat, fuqinë detyruese të arsyetimit të vendimit të saj.

3. Në vendimin objekt shqyrtimi, rezulton se Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka bërë të njëjtin interpretim ligjor për rekursin e kërkuesit, duke e konsideruar atë të paraqitur si jashtë afatit 30-ditor, ndërkohë që me vendimin nr.22, datë 26.7.2006, Gjykata ka evidentuar parregullsinë e procesit ligjor të zhvilluar në Gjykatën e Lartë, për shkak të mohimit të së drejtës për akces. Mbi këtë bazë, Gjykata ka konkluduar se rekursi është paraqitur në afat dhe kërkuesit nuk mund t'i cenohet e drejta për t'iu drejtuar gjykatës për shkaqe që rrjedhin nga mangësitë apo gabimet në veprimtarinë e vetë organeve shtetërore.

Një përfundim të tillë Gjykata e ka arritur duke analizuar në aspektin kushtetues vetëm fakte që lidhen drejtpërdrejt me juridiksionin e saj. Gjykata rithekson qëndrimin, se problemet e interpretimit dhe zbatimit të ligjit, që në parim u takojnë gjykatave të sistemit të zakonshëm, mund të merren në konsideratë prej saj vetëm nëse përmes këtij procesi janë cenuar të drejtat kushtetuese të individit për një proces të rregullt ligjor (*shih vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr.35, datë 20.12 2005; nr.4, datë 28.2.2006, nr.11, datë 23.4.2009*).

Në jurisprudencën e saj Gjykata ka pranuar mënyrë të vazhdueshme se marrja dhe vlerësimi i fakteve dhe i rrethanave, interpretimi i ligjit material dhe procedural, dhe aplikimi i tij në çështjet konkrete janë çështje që ndajnë juridiksionin e gjykatave të zakonshme nga juridiksioni kushtetues. Gjykata ndërhyn vetëm në ato raste kur përmes veprimeve të tyre, gjykatat e zakonshme cenojnë të drejtën për një proces të rregullt ligjor. Në këto raste, Gjykata nuk bën rivlerësimin e fakteve e rrethanave, por një vlerësim të natyrës kushtetuese, të dallueshëm nga ai i gjykatave të juridiksionit të zakonshëm. Gjykata e analizon faktin dhe rrethanën përkatëse në atë dimension që ka ndikim mbi të drejtat dhe liritë e parashikuara nga neni 42 dhe 131, shkronja "f", të Kushtetutës, gjë e cila përbën juridiksionin e saj kushtetues. Detyra e Gjykatës nuk është zgjidhja e një mosmarrëveshjeje juridike për çështje fakti, por identifikimi i fakteve të natyrës kushtetuese, të cilat shërbejnë për realizimin e kompetencave të saj dhe përbëjnë elementin thelbësor në përcaktimin e autoritetit të një gjykimi kushtetues.

Në një gjykim kushtetues përcaktohen dhe vlerësohen saktësisht faktet me qëllim nxjerrjen e konkluzionit për respektim të drejtë të standardeve kushtetuese. Prandaj, faktet e natyrës kushtetuese mund të vlerësohen nga Gjykata vetëm nëse një analizë e tillë është e domosdoshme për ushtrimin e juridiksionit të saj. Meqenëse në gjykimin kushtetues mosmarrëveshjet për analizën e fakteve materiale janë të pashmangshme, është e domosdoshme që faktet në çështje të kësaj natyre të provohen. Kryerja e një detyre të tillë përfshin zbatimin dhe interpretimin e Kushtetutës, jo në një boshllëk abstrakt, por në lidhje me situata të caktuara faktike. Nëse analiza e fakteve dhe rrethanave në këndvështrimin kushtetues nuk do t'i njihej Gjykatës Kushtetuese, atëherë do të rezultonte një cenim i të drejtës së individit për akces nga vetë kjo Gjykatë. Prandaj dhe misioni për organin që ushtron drejtësinë kushtetuese është që të vendosë nëse veprime të caktuara janë në pajtueshmëri ose jo me Kushtetutën.

Nga kjo pikëpamje, Gjykata çmon se edhe kontrolli i kushtetutshmërisë së vendimit gjyqësor vlerësohet në një kontekst të caktuar faktesh që lidhen me të drejtën për proces të rregullt ligjor. Rastet që i paraqiten Gjykatës mbi bazën e ankimit të individëve duhet të shqyrtohen domosdoshmërish në bazë të provueshmërisë së fakteve të dhëna. Marrja e vendimit për çështje kushtetuese është e kondicionuar nga përcaktimi i atyre fakteve kushtetuese, mbi bazën e të cilave vlerësohet respektimi i së drejtës për një proces të rregullt ligjor. Përderisa Gjykata Kushtetuese ka autoritetin për të vendosur përfundimisht për çështje të kushtetutshmërisë së procesit gjyqësor, ajo nuk mund të ushtrojë këtë kompetencë pa analizuar faktet e natyrës kushtetuese. Në këtë kontekst, Gjykata i referohet edhe Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut, e cila është shprehur se "për përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve nga një "gjykatë" në respekt të nenit 6, paragrafi 1 [i KEDNJ], është e domosdoshme që "gjykata" në fjalë të ketë juridiksion për të shqyrtuar të gjitha aspektet e faktit dhe të ligjit që kanë lidhje me çështjen përpara saj (*shih vendimet Le Compte, Van Leuven dhe De Meyere v. Belgjikës e*

datës 23.06.1981, apo Fischer v. Austrisë e datës 26.04.1995).

Nga kjo analizë kushtetuese e problemit, Gjykata thekson se, si rrjedhojë e moszbatimit nga Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë të vendimit të Gjykatës Kushtetuese që ka zgjidhur përfundimisht çështjen e të drejtës së kërkuesit për t'iu drejtuar gjykatës, është cenuar standardi kushtetues i së drejtës për një proces të rregullt ligjor, parashikuar nga neni 42 i Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, duke u bazuar në nenet 131, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "g" të Kushtetutës, si dhe në nenet 23, 72 e 77 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", me shumicë votash,

VENDOSI:

- Shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të vendimit nr.00-2007-1470 (1181), datë 18.10.2007, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.
- Dërgimin e çështjes për shqyrtim në Gjykatën e Lartë.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë pro: Kujtim Puto, Fehmi Abdiu, Petrit Plloçi, Xhezair Zaganjori, Sokol Sadushi, Admir Thanza, Sokol Berberi

Anëtarë kundër: Vladimir Kristo (kryetar), Vitore Tusha

MENDIM PAKICE

Jam kundër vendimit të shumicës për këto arsye:

1. Shumica e mbështet vendimin e saj për pranimin e kërkesës së Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave për shfuqizimin si antikushtetues të vendimit nr.00-2007-1470 (1181), datë 18.10.2007 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, kryesisht në nenin 132 të Kushtetutës, i cili bën fjalë për fuqinë detyruese të vendimeve të saj. Shumica arsyeton se si "…rrjedhojë e moszbatimit nga Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë të vendimit të Gjykatës Kushtetuese që ka zgjidhur përfundimisht çështjen e të drejtës së kërkuesit për t'iu drejtuar gjykatës, është cenuar standardi kushtetues i së drejtës për një proces të rregullt ligjor, parashikuar nga neni 42 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (fq.8).

2. Kjo çështje është shqyrtuar dhe më parë në Gjykatën Kushtetuese dhe me vendimin nr.736, datë 28.4.2005, kjo gjykatë shfuqizonte si antikushtetues vendimin nr.736, datë 28.04.2005 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, sipas të cilit rekursi i paraqitur nga ana e kërkuesit në Gjykatën e Lartë ishte jashtë afatit dhe për këtë arsye ky kolegj vendoste pushimin e gjykimit të çështjes. Të njëjtin qëndrim

ka mbajtur Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë edhe në vendimin e përmendur më lart në pikën 1.

3. Dy janë problemet që shtrohen për diskutim:

Së pari, a e ka zbatuar Gjykata e Lartë (kolegji përkatës) vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.736, datë 28.4.2005?

Së dyti, pas shfuqizimit të vendimit nga Gjykata Kushtetuese, a ka të drejtë Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë t'i rikonsiderojë faktet dhe të vendosë përfundimisht, apo ky kolegj në mënyrë formale duhet t'i bindet analizës së këtyre fakteve dhe përfundimeve të arritura nga Gjykata Kushtetuese? Problemet në aspektin teorik janë tepër të ndjeshme, sepse lidhen me juridiksionet e dy gjykatave, Gjykatës së Lartë dhe Gjykatës Kushtetuese, juridiksionit të gjykimit në rrugë të zakonshme dhe gjykimit kushtetues, çështje këto tepër të diskutuara dhe në jurisprudencën kushtetuese.

4. Kërkuesi ka pretenduar se Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, duke e vlerësuar rekursin e tij si të paraqitur jashtë afatit, i ka mohuar të drejtën e aksesit, si dhe të drejtën e ankimit në një gjykatë më të lartë, të cilat, në kuptim dhe të neneve 42, 43 e 131/f të Kushtetutës, e bënë procesin të parregullt nga pikëpamja kushtetuese.

Shumica gabon kur vlerëson faktet lidhur me paraqitjen ose jo në afat të rekursit në Gjykatën e Lartë, duke dalë tërësisht jashtë natyrës së gjykimit kushtetues dhe duke marrë atributet e një gjykate të zakonshme. Ajo gabon kur të njëjtat fakte e rrethana merr përsipër t'i vlerësojë dhe të arrijë në përfundime të ndryshme nga Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë. Në vendimin e saj, shumica, ndonëse me të drejtë, arsyeton se "marrja dhe vlerësimi i fakteve dhe i rrethanave…në çështjet konkrete janë çështje që ndajnë juridiksionin e gjykatave të zakonshme nga juridiksioni kushtetues", ajo nuk thotë asgjë kur në mënyrë të sforcuar përpiqet të arsyetojë më poshtë se "gjykata e analizon faktin dhe rrethanën përkatëse në atë dimension që ka ndikim mbi të drejtat dhe liritë e parashikuara nga nenet 42 dhe 131, shkronja "f", të Kushtetutës" (fq.7). Tjetër gjë është të vlerësosh një fakt të padiskutueshëm dhe ta ballafaqosh atë me standardet kushtetuese dhe tjetër gjë të vlerësosh një fakt që buron nga analiza dhe çmimi i provave apo rrethanave të çështjes. Pikërisht kjo e fundit nuk është dhe nuk mund të jetë atribut i Gjykatës Kushtetuese, e cila në asnjë rast dhe asnjë rrethanë nuk mund të vlerësojë ndryshe provat apo rrethanat, të cilat janë vlerësuar më parë nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, gjë e cila do ta shndërronte atë në një gjykatë të shkallës së katërt.

5. Duke konsideruar praktikën e mëparshme të Gjykatës Kushtetuese, megjithatë, çështja paraqitet problematike në aspektin teorik edhe lidhur me pranimin ose jo në rastin konkret të cenimit të aksesit për t'iu drejtuar gjykatës kur është fjala për rekursin në Gjykatën e Lartë, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës. Rekursi në Gjykatën e Lartë, në kuptimin juridik, është një mjet i jashtëzakonshëm që ushtrohet në kushtet dhe rrethanat e përcaktuara në nenet 472-493 të Kodit të Procedurës Civile. Vendimi është përfundimtar dhe merr formë të prerë në gjykatën e apelit në një nga mënyrat e parashikuara në nenin 466 të Kodit të Procedurës Civile. Kërkuesi e ka gëzuar të drejtën e aksesit plotësisht si në gjykatën e shkallës së parë, ashtu dhe në gjykatën e apelit, e cila ka dhënë një vendim përfundimtar të formës së prerë. Ndërsa për rekursin në Gjykatën e Lartë, të vetmet raste kur mund të shtrohet për diskutim problemi i cenimit të aksesit si standard kushtetues, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës, janë ato që bëjnë fjalë për rishikimin e vendimeve të formës së prerë të gjykatës, të parashikuara nga nenet 494-500 të Kodit të Procedurës Civile, pra kur si pasojë e konstatimit të pranisë së rrethanave të parashikuara në to çështja në themel mund të merrte një zgjidhje tjetër. Për t'iu drejtuar Gjykatës së Lartë, kërkuesi në rastin konkret (por dhe në çdo rast tjetër) mund t'i referohet një të drejte tjetër kushtetuese, asaj të ankimit në një gjykatë më të lartë, të parashikuar nga neni 43 i Kushtetutës, të drejtë që ai e ka realizuar pa asnjë cenim.

6. Vendimi i shumicës është i pabazuar edhe kur vlerëson se Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr.00-2007-1470 (1181), nuk ka zbatuar vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.22, datë 26.7.2006, duke shkelur kështu nenin 132 të Kushtetutës. Sipas këtij neni, vendimet e Gjykatës Kushtetuese kanë fuqi detyruese të përgjithshme dhe janë përfundimtare. Gjykata Kushtetuese ka vetëm të drejtën e shfuqizimit të akteve që shqyrton. Në vendimin e përmendur më lart, Gjykata Kushtetuese ka shfuqizuar si antikushtetues vendimin e mëparshëm të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë nr.736, datë 28.4.2005. Fakti se kemi një vendim të ri të marrë nga Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, pas shfuqizimit të vendimit të mëparshëm nga Gjykata Kushtetuese, është një tregues që flet qartë se ajo Gjykatë ka respektuar fuqinë detyruese të vendimit të Gjykatës Kushtetuese, në kuptim të nenit 132 të Kushtetutës. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka rivleresuar provat dhe rrethanat e

çështjes dhe ka arritur në të njëjtin përfundim me kolegjin e mëparshëm, duke ushtruar kështu tagrat e veta kushtetuese në sferën e gjykimit në rrugën e zakonshme. Shumica, pa vend, për të mbështetur përfundimet e saj për këtë çështje i referohet edhe nenit 145/2 të Kushtetutës. Ky nen, në mënyrë të qartë, bën fjalë për çështjet që i vijnë Gjykatës Kushtetuese nga gjyqtarët, të cilët, kur çmojnë se ligjet vijnë në kundërshtim me Kushtetutën, nuk i zbatojnë ato dhe vendosin pezullimin e gjykimit. Natyrisht, një vendim i Gjykatës Kushtetuese për kushtetutshmërinë apo jo të një ligji të kundërshtuar në rrugë incidentale, është i detyrueshëm për të gjitha gjykatat. Pikërisht ky është kuptimi i nenit 145/2 të Kushtetutës. Duket qartë se ky rregullim kushtetues nuk ka lidhje me çështjen në shqyrtim.

Anëtar: Vladimir Kristo (kryetar)

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi "Zhan d'Ark", prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", tel: 04 258 472 (Kryeredaktori).
Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2009 është 16 000 lekë.
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

KODI I PROCEDURËS CIVILE ……...……	240 lekë
KODI PENAL …….....…….……..	226 lekë
KODI I PROCEDURËS PENALE.....……....	330 lekë
KODI CIVIL ……	410 lekë

Hyri në shtyp më 3.7.2009
Doli nga shtypi më 3.7.2009

Tirazhi: 3300 copë	Formati: 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2009

Çmimi 36 lekë